



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 janar 2015
Nr. ref.:RK774/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI112/14

Parashtrues

Srboljub Krstić

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 63/2014, të 3 prillit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga :

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Alaty Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Srboljub Krstić, nga fshati Preoc, komuna e Graçanicës, të cilin e përfaqëson avokati z. Isak Islami nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 63/2014, të 3 prillit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 63/2014] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 3 prillit 2014, me të cilin, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, është shkelur neni 3 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/ L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI112/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI112/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 29 shtator 2014, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 22 tetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 10 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesëpadinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamentit në Graçanicë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër z. A. N., me vendbanim në Smederevë, Republika e Serbisë, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelën në sipërfaqe prej 712 m², e cila në regjistrimin kadastral evidentohet me shenjën P-73414058-00353-2.
10. Parashtruesi i kërkesës në kërkesëpadinë ka cekur se vlera e kontestit në këtë çështje juridike është 300 (treqind) euro.
11. Më 15 qershor 2013, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [P. nr. 2673/12] me të cilin kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që në afat prej 3 (tri) ditësh nga dita e

pranimit të Aktvendimit të plotësojë kërkesëpadinë, dhe ta shkruajë saktë adresën e të paditurit.

12. Më 31 korrik 2013, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [P. nr. 2673/12] me të cilin konsideron që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është tërhequr në pajtim me nenin 102.3 dhe nenin 112 të Ligjit për procedurën kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK).
13. Të njëjtën ditë (31 korrik 2013), parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të 31 korrikut 2013.
14. Më 25 tetor 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [Pž. nr. 2882-2013] me të cilin hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar ndërsa Aktvendimin e Gjykatës Themelore [P. nr. 2673/12] të 31 korrikut 2013, e vërtetoi në tërësi. Në konkludimin e Aktvendimit, Gjykata e Apelit theksoi: „ ... se ankesa e parashtruesit të kërkesës nuk bazohet në baza ligjore, sepse me arsyet ankimore, parashtruesi i kërkesës nuk ka kontestuar gjendjen faktike në të cilën është bazuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë”.
15. Më 7 shkurt 2014, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
16. Më 3 prill 2014, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] me të cilin e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për revizion si të palejuar në pajtim me nenin 211.3 të LPK-së.

Ligji relevant

Ligji për procedurën kontestimore (LPK) nr. 03/L- 006

Neni 102.3.: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë...”*.

Neni 112.: *“Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t’ia lë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t’ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi në kërkesë theksoi se me Aktvendimin e kontestuar [Rev. nr. 63/2014] të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, dhe atë: neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili parasheh se Republika e Kosovës është shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera që qeveriset në mënyrë demokratike, me

respektim të plotë të sundimit të ligjit, nëpërmjet institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

18. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë:

“Me këtë shkresë dëshirojmë të arrijmë respektimin e ligjit dhe evidentimin e shkeljeve, duke kërkuar miratimin e revizionit të datës 03.04.2014 të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili është në kundërshtim me revizionin e kërkuar i cili është në kundërshtim me rregullat ligjore ku në bazë të revizionit nuk kemi paraqitur shumë më të vogël se 3000 euro. Andaj, Gjykata Supreme e Kosovës është dashur të shqyrtoj kërkesën e revizionit e ushtruar më afat ligjor, e jo të refuzoj atë me vendimin 63/2014“.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës të Gjykatës.

20. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar“.

22. Siç është cekur më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon që me Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 3 prillit 2014, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
23. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë nuk ka shpjeguar si dhe pse me Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, por pretendimet e tij në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Kushtetutës i justifikon me qëndrimin: „ [...] se Kosova është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore”.
24. Gjykata Kushtetuese rithekson se, sipas Kushtetutës nuk është detyrë e saj që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t’i interpretojnë dhe zbatojnë

rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtruesit e kërkesës Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

25. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm t'i shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të rregullt dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, ndërmjet burimeve të tjera, rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
26. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme me Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] të 3 prillit 2014, refuzoi kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës në pajtim me nenin 211.3 të LPK-së.
27. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se neni 211.3 i LPK-së parasheh: “*Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro*”.
28. Prandaj, Gjykata është e mendimit se shpjegimi i dhënë nga Gjykata Supreme në Aktvendimin [Rev. nr. 63/2014] është i qartë dhe ligjërish i argumentuar, dhe se procedurat para Gjykatës Supreme dhe gjykatave të tjera të rregullta nuk ishin të padrejta dhe arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, vendimi i GJEDNJ-së të 30 qershorit 2009).
29. Gjykata vëren se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e rastit nuk mund vetvetiu ti jep të drejtë të iniciojë një pretendim të argumentuar për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrik 2005).
30. Si përmbledhje, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet për pranueshmëri, duke pasur parasysh që parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.
31. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet si e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 22 tetor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani